

ELTON TIRANA

# RAPORTI I TRANSPARENCËS

20

22

# PËRMBAJTJA

---

**01**

**Njohje me Raportin e  
Transparencës për vitin 2022**

**02**

**Mesazh nga Partneri i Vetëm**

**03**

**Qasja jonë për ofrimin e  
shërbimeve me cilësi**

**04**

**Theks i veçantë në cilësinë e  
auditimit**

**05**

**Përdorimi i teknologjisë për të  
mbështetur ekipin tonë**

**06**

**Deklarata e drejtimit mbi  
efikasitetin e sistemit të  
kontrollit të brendshëm të  
cilësisë**

**07**

**Konsiderata lidhur me  
kryerjen e auditimeve**

**08**

**Pranimi dhe vazhdimi i  
marrëdhënieve me klientët  
dhe misionet e auditimit**

**09**

**Aneks**

# PREZANTIM

Ky Raport përmban informacion mbi strukturën dhe shërbimet që ofron firma jonë e auditimit. Si profesion, auditimi është vazhdimisht në qendër të krijimit të besueshmërisë së të dhënave sensitive financiare lidhur me kompanitë dhe për këtë arsye cilësia e shërbimeve të auditimit dhe dhënies së sigurisë që ne u ofrojmë klientëve është thelbësore për të mbrojtur besimin e investitorëve dhe palëve të tjera të interesuara për integritetin e biznesit tonë.

Strategjia jonë - "Të Qënit Profesionit me Vlera" – mishëron angazhimin tonë për të operuar me cilësi dhe integritet. Misioni ynë është ndërtimi i besimit në shoqëri dhe zgjidhja e problemeve të rëndësishme financiare.

Ne synojmë të ofrojmë profesionalitet që bazohet mbi vlera. Ne vazhdojmë të investojmë tek njerëzit, duke siguruar zhvillimin e tyre me trajnime profesionale dhe personale përmes programeve të veçanta të trajnimit dhe kemi ndërmarrë hapa për të realizuar punën tonë me cilësi e integritet.

Ne investojmë vazhdimisht në aplikimin dhe përditësimin në njohuri dhe teknologji të reja në dobi të të gjitha shërbimeve të ofruara nga firma jonë e auditimit. Në këtë mënyrë, ne mund të përballojmë sfidat e auditimit të paraqitura nga epoka dixhitale, por edhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve që ne ofrojmë. Së bashku, këto masa përfaqësojnë një transformim të rëndësishëm të punës sonë të auditimit dhe na mbështesin në fokusimin tonë, të cilat i japin cilësi auditimit dhe përgjegjësi tona me interes publik.

Ne kemi hartuar këtë raport transparence për vitin financiar të përfunduar më 31 Dhjetor 2022, në përputhje me kërkesat e nenit 13 të Rregullores së BE -së nr. 537/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 16 Prillit 2014 mbi kërkesat specifike në lidhje me auditimin ligjor të subjekteve me interes publik.

# MESAZH NGA PARTNERI I VETËM

Çdo gjë që bëjmë bazohet në besim. Ky është një kusht themelor për përmbushjen e Misionit nga ne, dhe një nga mënyrat për të cilën ne krijojmë besim është për të siguruar transparencë. Cilësia është në zemër të asaj që bëjmë dhe mbetet themeli i prioriteteve tona strategjike. Përkushtimi ynë ndaj sjelljes etike dhe përqaimit të standardeve mbi të cilat mbështetet profesioni ynë – bazuar në objektivitet, gjykimin profesional dhe skepticizmin – është thelbësore në punën tonë. Kjo është arsyeja pse ne jemi entuziastë për punën e realizuar dhe me kënaqësi ju paraqesim Raportin tonë të Transparencës për vitin financiar të përfunduar më 31 Dhjetor 2022, i cili paraqet rrugën e ndjekur dhe parimet mbi të cilat bazohet profesionalizmi dhe cilësia e punës sonë.

Ne jemi shumë të vetëdijshëm për detyrimin tonë lidhur me ofrimin e shërbimeve cilësore të auditimit, që garanton funksionimin e qëndrueshëm të aktivitetit ekonomik të entiteteve në një treg global që paraqet sfida dhe kriza të njëpasnjëshme. Për këtë arsye, ne mbetemi vigjilentë dhe të përkushtuar ndaj cilësisë, profesionalizmit, sjelljes etike dhe integritetit.

Raporti përshkruan politikat, sistemet dhe proceset tona të sigurimit të cilësisë, rezultatet e programeve kryesore dhe analizat e monitorimit të cilësisë, gjithashtu, dhe si promovojmë një kulturë cilësie në çdo nivel të firmës. Dokumenti paraqet kompanitë për të cilat kemi kryer auditimet dhe të ardhurat totale nga aktiviteti auditimit/dhënies së sigurisë. Puna jonë e auditimit është themelore për strategjinë dhe emrin e firmës tonë. Ne vazhdojmë të investojmë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së auditimit përmes sistemeve, teknologjive, proceseve të reja, menaxhimit të rrezikut dhe programet e menaxhimit, mësim dhe zhvillim për punonjësit tanë.




**Ne jemi të përkushtuar për të identifikuar dhe kuptuar nevojat e klientëve tanë, për t'i ndihmuar të arrijnë vendimmarrjen më të mirë që do t'i drejtojë ata drejt suksesit, duke ruajtur pavarësinë dhe objektivitetin tonë profesional.**

# ORGANIGRAMA DHE PRONËSIA

Elton Tirana, Person Fizik është i regjistruar në QKB dhe themeluar në datë 12/04/2010, në adresën: Tiranë, Rruga "Komuna e Parisit", Kompleksi Kika, Ap. 8.

Firma zotërohet 100% nga Partneri i vetëm dhe ofron Shërbime të Dhënies së Sigurisë: të tilla si Auditime, Rishikime, dhe Përpilime. Të tjera shërbime përfshijnë Raportim Financiar/Angazhimet e Përpilimit, përfshijnë zhvillimin dhe mbajtjen e regjistrimeve dhe sistemeve financiare, përpilimin e pasqyrave financiare të klientëve dhe të çdo raporti tjetër financiar që kërkohet. Gjithashtu, ne asistojmë në përgatitjen e çdo raporti që kërkohet nga klientët për raportim të brendshëm apo qëllime të jashtme.

Shërbime Jo- të Dhënies së Sigurisë: të tilla shërbime përfshijnë hartimin e kontrolleve të brendshme, shërbime lidhur me taksat, këshillim manaxherial dhe biznesi, dhe shërbime të tjera financiare, që ndihmojnë në përmirësimin e performancës së klientëve.



# QASJA JONË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE ME CILËSI

---

## Theksimi i Cilësisë

Cilësia e veprimtarisë është themeli i parimeve të firmës dhe ne po investojmë burime të konsiderueshme dhe në rritje në përmirësimin e tij të vazhdueshëm në të gjitha fushat tona të veprimtarisë. Ky investim synohet në fusha të ndryshme, përfshirë trajnime (teknike, etike dhe të sjelljes), metodologji, burime shtesë në fushat kryesore dhe eksplorimin e mënyrave të reja të punës. Ne gjithashtu, po investojmë shumë në teknologjitë e reja për përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive dhe efikasitetin e të gjitha shërbimeve tona. Për ne është shumë e rëndësishme të jesh transparent, si në aspektin e përpjekjeve që bëjmë ne për rritjen e cilësisë, si dhe rezultatet dhe ndikimin e këtyre përpjekjeve.

## Përkufizimi dhe kultura

Ne përcaktojmë shërbimet cilësore si ato, të cilat i përmbushin vazhdimisht pritjet e palëve të interesuara dhe në përputhje me të gjitha standardet dhe politikat në fuqi. Një pjesë e rëndësishme e sigurimit të rezultateve në përputhje me këtë përkufizim të cilësisë po ndërton një kulturë që thekson mbi përgjegjësinë e secilit për cilësinë brenda firmës dhe jashtë saj.

## Vlerësimi dhe transparenca

Në të gjitha aktivitetet tona duhet të ketë një sistem të zbatuar menaxhimi rigoroz të cilësisë (SoQM) dhe të komunikohen rezultatet e këtyre vlerësimeve tek drejtimi. Këto rezultate diskutohen më vonë detajuar në takimet me stafin, dhe nëse nuk është në nivelin e pritur, plane dhe masa të reja ndërmerren për një sistem efektiv. Ndërsa shërbimet tona evoluojnë, po kështu zhvillohen dhe nevojat e pritjet e palëve të interesuara, duke sjellë si rezultat rishikimin e vazhdueshëm të operacioneve dhe sistemit tonë të kontrollit të cilësisë.

# QASJA JONË PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE ME CILËSI

---

## Theks i veçantë në cilësinë e auditimit

Sigurimi i auditimeve cilësore është qëllimi ynë thelbësor. Në këtë kuptim, ne jemi të përkushtuar të sigurojmë një kontroll cilësor. Megjithatë, ku aktiviteti ynë nuk arrin në standardet që kemi vendosur ose janë krijuar nga rregullatorët, ne trajtojmë secilin nga këto raste me seriozitetin e duhur dhe ne bëjmë çdo përpjekje për të nxjerrë mësimet e përshtatshme dhe rrisim cilësinë e auditimeve në të ardhmen.

## Objektivat dhe aftësitë e duhura

Për të na ndihmuar ta zbatojmë këtë strategji bazuar mbi cilësinë, firma jonë ka vendosur qëllime të qarta mbi cilësinë e auditimit dhe na siguron mbështetje për të na ndihmuar të arrijmë këto qëllime. Stafi ynë mund të përfshihet në angazhime vetëm nëse ata kanë qasje në aftësitë e nevojshme - si njerëzore ashtu edhe teknologjike. Për këtë arsye, synimet tona cilësore fokusohen në aftësitë e duhura. Këto aftësitë mund të zhvillohen vetëm me lidërsip dhe kulturën e cilësisë së përshtatshme, promovimin e vlerave dhe sjelljet e duhura.

## Integrimi dhe harmonizimi i duhur

Për qëllimet tona ne sigurohemi që njerëzit e duhur mbështeten nga metodologji, procese dhe teknologji efikase. Këto paraqesin aftësitë, që ne i konsiderojmë të rëndësishme për arritjen dhe ruajtjen e cilësisë në auditim.

Objektivat e cilësisë mbështeten nga aktivitete kryesore specifike të konsideruara të nevojshme për të arritur objektivat cilësore, të fokusuara kryesisht në ndërtimin e një infrastrukture cilësore. Ne planifikojmë dhe ndërmarrim aktivitete të tilla kryesore sipas nevojës, për t'iu përgjigjur rreziqeve që kemi identifikuar në përpjekje për të arritur çdo qëllim cilësor.

## Vlerat dhe vendimet

Kryerja e auditimeve cilësore do të thotë shumë më shumë sesa procese të drejta. Këto përfshijnë një sjellje etike në përputhje me vlerat e Firmës, skepticizëm profesional, aftësitë e një specialisti dhe arsyetimi - të gjitha të mbështetura nga teknologjia e duhur.

---

# PËRGJIGJJA JONË DHE MASAT E MARRA NDAJ COVID-19

---

Pandemia globale e COVID-19 pati një ndikim të paparë tek klientët dhe te punonjësit, por edhe për ekonominë globale dhe shoqërinë në tërësi. Në firmën tonë, përveç mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies së punonjësve tanë, ne mbetemi të përkushtuar në bashkëpunim të ngushtë, me klientët tanë dhe me aktorë të tjerë për të vazhduar të ofrojmë auditime me cilësi.

Roli ynë si auditues ligjorë në sigurimin e cilësisë, besueshmërisë dhe transparencës, si dhe gjithëpërfshirjes dhe efektivitetit është më kritike se kurrë. Për këtë qëllim, ne jemi bazuar në Manualin për Audituesit gjatë Pandemisë COVID të botuar nga IAASB, i cili thekson rëndësinë e kujdesit të veçantë ndaj Konsideratave të Auditimit të ngritura nga ndryshimet prej COVID-19, Llogaritjet Kontabile, Çështja e vijimësisë së biznesit, Ngjarjet pasuese, Raportimi, Raportimi i brendshëm, Mashtrimi dhe aktivitetet e paligjshme.

## 01 — Ne ndajmë njohuri dhe përvojë

Që nga fillimi i pandemisë, firma jonë ka monitoruar me kujdes zhvillimet në nivel global dhe nxjerr në pah fushat me rëndësi kritike, në mënyrë që të sigurohet se ne nuk bëjmë kompromis për cilësinë e auditimit.

## 02 — Identifikimi dhe adresimi i rreziqeve që lidhen me COVID-19

Pandemia COVID-19 na vuri në një situatë ku u përballëm me sfida të pashembullta gjatë auditimeve tona. Këto kanë ndryshuar shumë nga hapat e ndjekur gjatë planifikimit dhe proceset tona gjatë auditimit, në mënyrën se si ndërveprojmë me klientët për të marrë dëshmitë e nevojshme të auditimit dhe procedura specifike të auditimit. Sistemi ynë i menaxhimit të cilësisë siguron kuadrin për identifikimin, vlerësimin dhe përgjigjen e rrezikut që dalin nga situata e krijuar nga pandemia e COVID-19. Kemi përdorur përvojën dhe shembujt që kemi marrë nga organizmat standard-vënësë për të vlerësuar çështjet me rrezik që ndikojnë në sistemin tonë të menaxhimit të cilësisë. Në nivelin territorial, ne kemi zbatuar një plan rishikimi të angazhimeve të auditimit për klientët me rrezik të lartë dhe që janë prekur nga COVID-19.



## PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË PËR TË MBËSHTETUR EKIPIN TONË



Firma jonë u përshtat shumë shpejt me ndryshimet dhe kufizimet e ndodhura prej pandemisë globale, duke bërë të mundur vazhdimin e punës me efikasitet në distancë. Infrastruktura dhe mjetet tona, teknologjia dhe interneti kanë lejuar punonjësit të vazhdojnë të operojnë pavarësisht ndryshimeve të rëndësishme në mjedisin tonë fizik. Ndikimi i COVID-19 vazhdon të ndihet. Ne vazhdojmë të monitorojmë, vlerësojmë dhe ne i përgjigjemi rreziqeve të identifikuara në auditime me mbështetjen e teknologjisë.

Përpunimi dhe ruajtja e të dhënave financiare dhe jo financiare kërkon kujdes të veçantë dhe përdorim të programeve kompjuterike të veçanta e për këtë arsye firma jonë ka krijuar dhe inkorporuar programe të ndryshme për përpunimin dhe ruajtjen e tyre. Gjithashtu, punonjësit tanë janë të vetëdijshëm dhe të njohur me përdorimin e Inteligjencës artificiale në përpunimin e të dhënave.

# DEKLARATA E DREJTIMIT MBI EFIKASITETIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

---

Firma jonë konsideron se sistemi i kontrollit të cilësisë i përshkruar në këtë raport përputhet me të gjitha rregulloret në fuqi dhe siguron një bazë referimi për të konsideruar misionet e auditimit ligjor të kryera në përputhje me standardet e cilësinë e kërkuar. Monitorimi i cilësisë është një pjesë integrale e programit të përmirësimit të vazhdueshëm të Firmës. Firma jonë e auditimit vazhdimisht vlerëson kontributet e programeve formale dhe shumëllojshmërinë e burimeve joformale në një përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar politikat, procedurat dhe qëndrueshmërinë e cilësisë së auditimeve. Rastet e mospërputhjes me standardet e performancës, nëse ka, trajtohen me seriozitetin më të lartë dhe partneri përgjegjës udhëzohet të përmirësojë performancën e tyre.

## **PROCEDURAT TONA TË KONTROLLIT TË CILËSISË JANË TË DETAJUARA NË MANUALIN E KONTROLLIT TË CILËSISË SË FIRMËS HARTUAR NGA PARTNERI KRYESOR**

Politikat dhe procedurat janë të integruara në aktivitetet e zakonshme të kompanisë. Sistemi ynë i kontrollit të cilësisë bazohet në tetë komponentët e vendosur nga ISQM 1 dhe ISQM 2, të cilët janë:

- Procesi i vlerësimit të rrezikut të firmës;
  - Qeverisja dhe lidershipi;
  - Kërkesat përkatëse etike;
  - Pranimi dhe vazhdimësia e marrëdhënieve me klientin;
  - Performanca e angazhimeve;
  - Burimet;
  - Informacioni dhe komunikimi;
  - Procesi i monitorimit dhe riparimit.
-

# PËRDITËSIM MBI KONTROLLIN E CILËSISË: IMPLEMENTIMI I ISQM 1 & ISQM 2

---

Zbatimi i ISQM 1 & ISQM 2 duke filluar nga 15 Dhjetori, 2022 është një moment historik në botën e auditimit dhe shërbimeve të dhënies së sigurisë, që sjell ndryshime të rëndësishme në mënyrën se si firmat profesionale të kontabilitetit menaxhojnë cilësinë. ISQM 1 do të zëvendësojë standardin aktual të ISOC 1 dhe kërkon një qasje më proaktive dhe e bazuar në rrezik për menaxhimin e cilësisë në nivel firme.

ISQM 1 kërkon që firmat të hartojnë, zbatojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë Sistemin e përgjithshëm të Menaxhimit të Cilësisë (SOQM) në tetë komponentë të specifikuar që ofrojnë siguri të arsyeshme që një firmë do të përmbushë objektivat e përcaktuara të cilësisë.

ISQM 1 përfshin kërkesa më të forta për qeverisjen, udhëheqjen dhe kulturën e firmave të auditimit, si dhe prezanton një proces të vlerësimit të rrezikut për firmat që të vlerësojnë rreziqet për arritjen e objektivave të cilësisë dhe të hartojnë përgjigje që adresojnë ato rreziqe. Gjithashtu, standardi kërkon një monitorim më të gjerë të SOQM për të identifikuar mangësitë që kërkojnë veprime korigjuese dhe për të ofruar bazën për vlerësimin e përgjithshëm të efektivitetit të SOQM.

Zbatimi i ISQM 1 do të përmirësojë më tej qëllimin e firmës në shërbim të interesit publik si dhe qasjen tonë proaktive ndaj menaxhimit të cilësisë së angazhimeve të kryera, identifikimin dhe adresimin e rreziqeve për cilësinë e auditimit dhe nxitjen e përmirësimeve në proceset e kontrollit të cilësisë.

Standardet përfshijnë:

1. Standardin Ndërkombëtar për Menaxhimin e Cilësisë 1, Menaxhimi i cilësisë për firmat që kryejnë auditime ose rishikime të pasqyrave financiare, ose angazhime të tjera të Dhënies së Sigurisë, ose angazhime të Shërbimeve të Lidhura (ISQM 1);
2. ISQM 2 Rishikimet e cilësisë së angazhimit; dhe
3. ISA 220 i rishikuar, Menaxhimi i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare.

# PËRDITËSIM MBI KONTROLLIN E CILËSISË: IMPLEMENTIMI I ISQM 1 & ISQM 2

---

Manuali i ri i Menaxhimit të Cilësisë dhe Etikës do të zhvillohet në përgjigje të kërkesave të ISQM 1, ISQM 2 dhe ISA 220 të rishikuar. Ky manual përfshin udhëzime mbi qasjen e bazuar në rrezik, politika e procedura që kërkojnë plotësimin e kërkesave minimale, si dhe burimet për t'iu përgjigjur shumicës së rreziqeve. Këto politika dhe procedura do të përshtaten për të formuar bazën e sistemit të menaxhimit të cilësisë së firmës. Ky manual fokusohet në kërkesat e menaxhimit të cilësisë, etikës dhe pavarësisë në nivel firme.

Më specifikisht, Manuali përfshin komponentët e mëposhtëm:

- Krijimin e një sistemi të menaxhimit të cilësisë;
- Procesin e vlerësimit të rrezikut të firmës;
- Qeverisjen dhe lidërshtipin;
- Kërkesat etike dhe të pavarësisë;
- Politikën dhe procedurat për pranimin dhe vazhdimin e marrëdhënieve me klientët;
- Politikën dhe procedurat e Burimeve Njerëzore, Teknologjike dhe Intelektuale;
- Politikën dhe procedurat që adresojnë performancën e angazhimit;
- Informacionin dhe Komunikimin;
- Procesin e Monitorimit dhe Përmirësimit;
- Përgjigjet specifike;
- Vlerësimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë;
- Dokumentimin;
- Burimet për çdo seksion.

Ne besojmë se zbatimi i kërkesave të ISQM 1 do të jetë i dobishëm për të përmirësuar cilësinë në nivel firme dhe angazhimi, sepse një SOQM efektiv është themelor për të arritjen e cilësisë së qëndrueshme të angazhimit.

---

# DEKLARATA E DREJTIMIT MBI EFIKASITETIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

---

## Udhëheqja dhe përgjegjësia

Respekti dhe rëndësia që i kushtojmë cilësisë theksohet nga strukturat e dedikuara dhe burimet me përvojë të ofruara për arritjen e efikasitetit. Partneri kryesor mban takime të rregullta me stafin për të diskutuar çështjet kryesore të rrezikut dhe cilësisë, koordinon strategjinë e rrezikut dhe cilësisë dhe komunikon rregullisht me ta për çështjet e rrezikut dhe cilësisë. Firma jonë sigurohet që cilësia ofrohet si në operacionet e përditshme të firmës, ashtu dhe në angazhimet specifike të secilit punonjës, si dhe sigurohet që punonjësit e saj të kenë një ngarkesë pune në nivel të arsyeshëm duke mos vënë në rrezik cilësinë. Për më tepër, rishikimi vjetor i dosjeve të Partnerit dhe stafit na lejon të menaxhojmë në mënyrë efektive kërkesat për drejtuesit e misionëve të auditimit. Ne vazhdojmë të përqëndrohemi në përshtetimin e aktivitetit, i cili na lejon për të shpërndarë ngarkesën e punës në mënyrë më të barabartë gjatë gjithë vitit dhe për të zvogëluar disa nga periudhat e pikut. Ne u përgjigjemi në mënyrë proaktive rezultateve të anketimit të punonjësve dhe vazhdimisht po kërkojmë mënyra për të përmirësuar ekuilibrin midis jetës personale dhe profesionale, por edhe për të motivuar më mirë punonjësit tanë që të rrisin normat e mbajtjes së tyre.

## Etika, pavarësia dhe objektiviteti

### Etika

Firma jonë respekton parimet themelore të Këshillit për Standardet Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabilistë (IESBA), të cilët janë:

- Integriteti - sinqeriteti dhe ndershmëria në të gjitha marrëdhëniet profesionale dhe të biznesit;
  - Objektiviteti - ne nuk lejojmë që vendimet profesionale ose të biznesit të ndikohen nga paragjykimet, konfliktet e interesave ose ndikimit të papërshtatshëm;
  - Kompetenca dhe zell profesional - ne ruajmë njohuritë dhe aftësitë profesionale në një nivel përmes të cilit ne sigurohemi që një klient ose punëdhënës të përfitojë nga shërbimet dhe aftësitë profesionale, bazuar në praktikën, legjislacionin dhe teknikat aktuale, dhe ne veprojmë me zell dhe në përputhje me standardet teknike dhe profesionale në fuqi;
-

# DEKLARATA E DREJTIMIT MBI EFIKASITETIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

---

- Sjellja profesionale - ne respektojmë ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe shmangim çdo veprim që diskrediton profesionin. Përveç kësaj, standardet tona të firmës mbulojnë një sërë fushash, duke përfshirë sjelljen etike dhe të biznesit, pavarësinë, parandalimin e pastrimit të parave, konkurrencën e ndershme, anti-korrupsionin, mbrojtjen e informacionit, auditimin e brendshëm dhe keqpërdorimin e informacionit të brendshëm.

Ne i marrim seriozisht këto kërkesa etike dhe bëjmë çmos që t'i respektojmë. Të gjithë partnerët dhe punonjësit i nënshtrohen trajnimit vjetor dhe dorëzojnë deklaratat vjetore të pajtueshmërisë mbi kërkesat etike mbi të cilat ne punojmë. Krahas vlerave të Firmës (Ne veprojmë me integritet, kujdesemi, bashkëpunojmë), misioni i Firmës "Being Professional With Values" drejton stafin në përmbushjen e angazhimeve me cilësi dhe për këtë arsye Partneri kryesor punon dhe ka miratuar standardet, të cilat përfshijnë edhe politika të ndërlidhura, që përshkruajnë qartë sjelljet e dëshiruara të stafit tonë dhe profesionistë të tjerë - sjellje që do të na lejojnë të ndërtojmë besim tek publiku i gjerë. Ne presim që të gjithë punonjësit dhe partnerët t'i përmbahen vlerave të detajuara në kuadër të Kodit të Etikës dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit gjatë karrierës profesionale dhe ata kanë përgjegjësinë për të raportuar dhe shprehur çdo arsye për shqetësim dhe për të bërë të gjitha këto në mënyrë të drejtë, të ndershme dhe profesionale kur merren me situata të vështira ose kur vëzhgojnë sjellje që nuk përputhen me Kodin. Ne kemi siguruar dhe një mekanizëm të raportimit të problemeve.

## Objektiviteti dhe pavarësia

Si auditues të pasqyrave financiare dhe furnizues të shërbimeve profesionale të tjera, firma dhe punonjësit e saj kanë detyrimin të respektojnë parimet themelore të objektivitetit, integritetit dhe profesionalizmit. Për klientët që ofrohen shërbimet e auditimit, pavarësia është themeli i këtyre kërkesave. Respektimi i këtyre parimeve është thelbësore, sepse na lejon të përfitojmë nga klientët dhe tregjet e kapitalit. Politika e pavarësisë globale, e cila bazohet në Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionalistë, përfshirë Standardet ndërkombëtare të pavarësisë, bazohet mbi standardin, që firmat të jenë zotuar lidhur me pajtueshmërinë, përfshirë procedurat që duhen ndjekur për të ruajtur pavarësinë nga klientët kur është e nevojshme.

---

# DEKLARATA E DREJTIMIT MBI EFIKASITETIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

---

## Politikat dhe praktikat e pavarësisë

Politika e përgjithshme e pavarësisë mbulon, ndër të tjera, fushat e mëposhtme:

- pavarësinë personale dhe të kompanisë, përfshirë politikat dhe udhëzimet për interesa dhe angazhime të tjera financiare;
- marrëdhëniet e biznesit, përfshirë politikat dhe udhëzimet e bashkëpunimit të biznesit (të tilla si ndërmarrjet e përbashkëta dhe kompanitë e përbashkëta të marketingut) dhe blerjen e mallrave dhe shërbimet në aktivitetin aktual;
- pranimi i klientëve të rinj për aktivitetet e auditimit dhe pranimi i mëvonshëm i shërbimeve jo-auditimi për ata klientë.

## Trajnimi dhe konfirmimet e pavarësisë

Firma ofron për të gjithë punonjësit trajnim vjetor të vazhdueshëm mbi tema të ndryshme ku rol të rëndësishëm zë dhe pavarësia. Të gjithë partnerët dhe punonjësit kanë detyrimin që të plotësojnë një deklaratë vjetore të pajtueshmërisë me të cilën ai konfirmon se respekton aspektet e rëndësishme për politikën e pavarësisë së kompanisë, përfshirë pavarësinë personale të dikujt. Gjithashtu, i gjithë stafi sigurohen që të mos ofrojnë shërbime që bien ndesh me parimin e pavarësisë si shërbimet jo-audituese me shërbime auditimi/dhënie sigurie për të njëtin klient. Këto konfirmime vjetore plotësohen nga konfirmimet e nivelit të misionit për të gjithë njerëzit që punojnë për klientët e auditimit.

## Monitorimi dhe politika e pavarësisë disiplinore

Partneri kryesor është përgjegjës për monitorimin e efikasitetit të sistemit të firmës të kontrollit të cilësisë. Përveç deklaratave të përmendura më lart në këtë proces, ne gjithashtu kryejmë monitorime:

- Testet e pajtueshmërisë për kontrollet dhe procedurat e pavarësisë;
  - Testimi i pajtueshmërisë mbi pavarësinë, të dhënat personale të një mostre të rastësishme të përbërë nga të paktën partnerët dhe drejtorët, si mjet për monitorimin e pajtueshmërisë me pavarësinë; dhe
  - Një vlerësim vjetor i pajtueshmërisë nga kompania.
-

# KONSIDERATA LIDHUR ME KRYERJEN E AUDITIMEVE

---

Parimet që ne zbatojmë për momentin, të cilat përcaktojnë nëse duhet të pranojmë një klient të ri ose do të vazhdojmë ti shërbejmë një klienti ekzistues është çelësi për sigurimin e cilësisë së shërbimeve tona, çfarë ne konsiderojmë, është e ndërthurur me qëllimin për të ndërtuar besimin në shoqëri. Ne kemi zhvilluar politika dhe procedura, që zbatohen për pranimin e marrëdhënies me një klient dhe misionet e auditimit, në bazë të të cilave përcaktojmë nëse jemi kompetentë për të kryer misionin dhe nëse kemi aftësitë e nevojshme, përfshirë kohën dhe burimet, nëse ne mund të pajtohemi me kërkesat përkatëse etike, përfshirë pavarësinë, dhe nëse kemi të përcaktuar siç duhet integritetin e klientit.

## PRANIMI DHE VAZHDIMI I MARRËDHËNIEVE ME KLIENTËT DHE MISIONET E AUDITIMIT

---

Firma ka krijuar një proces identifikimi nëse duhet vazhduar marrëdhënia apo pranimi i një misioni. Konkretisht, ky sistem lejon:

Për ekipet e përfshira në misionet e auditimit,

- të dokumentojnë aspektet e analizuar sipas kushteve të vendosura nga standardet profesionale përsa i përket pranimit dhe vazhdimin të marrëdhënies profesionale;
  - të identifikojnë dhe dokumentojnë problemet ose faktorët e rrezikut dhe si të zgjidhen përmes metodave të tilla si konsultimet, përshtatja e planit të burimeve ose qasja ndaj angazhimit të auditimit ose përmes miratimit të masave të tjera zbutëse ose duke refuzuar kryerjen e misionit; dhe
  - të lehtësojnë vlerësimin e rreziqeve të lidhura, pranimin ose vazhdimin e marrëdhënies me një klient dhe një mision.
-



# PRANIMI DHE VAZHDIMI I MARRËDHËNIEVE ME KLIENTËT DHE MISIONET E AUDITIMIT

---

## Strategjia e burimeve njerëzore

Strategjia jonë e burimeve njerëzore fokusohet në të qëniet zhvillues i talenteve. Ne nxisim kandidatët, që kanë mendje kurioze të tregojnë guxim dhe integritet. Standardet tona të punësimit përfshijnë intervista të strukturuar me pyetje të sjelljes, që vlerësojnë, gjithashtu, njohuritë e marra gjatë studimeve dhe kontrollet e referencave profesionale. Kjo strategji përfshin tre elementë:

- Zhvillimin e aftësive dixhitale;
- Aftësitë për shoqërinë – duke zhvilluar aftësitë personale të stafit, që ndihmojnë në bashkëveprimin në mënyrë efektive dhe harmonike me njerëzit e tjerë;
- Mbështetje të mirëqenies më të gjerë për njerëzit tanë.

Tab. 1: Informacioni Financiar

Shënime shpjeguese në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr.10091, datë 05/03/2009, i ndryshuar me Ligjin nr.47/2016, datë 28/04/2016 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”.  
Ndarja e të ardhurave vjetore të P.Fizik Elton Tirana për vitin 2022:

Të ardhurat	LEK/në mijëra
Auditim ligjor ( NIP)	4,946
Auditim ligjor ( jo-NIP)	3,625
Shërbime jo auditimi ( entitete të tjera)	5,133
<b>TOTALI</b>	<b>13,704</b>

Tab. 2: Entitete të Interesit Publik

Shënime shpjeguese në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr.10091, datë 05/03/2009, i ndryshuar me Ligjin nr.47/2016, datë 28/04/2016 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.17, datë 16.01.2019, që përcakton se cilat kompani do të konsiderohen me “interes publik” përse i përket natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punonjësve.

Entitetet me Interest Publik të Audituar gjatë vitit financiar 2022 :

Emri i Subjektit
KESH Sh.a
REGENCY INTERNATIONAL CASINO TIRANA Sh.a
DITEKO Sh.p.k
HEC VLUSHE Sh.p.k
GAMA ENERGY Sh.p.k
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë
Partia Republikane Shqiptare
Partia e Gjelbër
Partia Nisma Thurje
Partia Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet